



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS



Kuvendi i Komunës

Nr.02/22.1

Datë: 18.11.2019

PROCESVERBAL

i mbledhjes së IX-të (nëntë) të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e VI-2019.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/125 datë:10.07.2019, për rritjen e buxhetit të hyrave vetanake për vitin 2018.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/126 datë:10.07.2019, për bartjen dhe ridestinimin e mjeteve vetanake nga viti 2017 dhe 2018 në vitin 2019.
4. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor i Drejtorisë për Shëndetësi për vitin 2019.
5. Shqyrtimi i vendimit lidhur me pagesën për nënat për çdo fëmijë të lindur.
6. Ndarja e mjeteve financiare me rastin e ndarjes së çmimeve sipas Statutit të Komunës për Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve të Komunës së Malishevës me 16 Qershor 2019, si dhe për vitet në vijim.
7. Shqyrtimi i Raportit të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2019.
8. Shqyrtimi i Raportit të DKAË-së për përfundimin e vitit shkollor 2018/2019 si dhe shqyrtimi i raportit për përgatitjet e fillimit të vitit shkollor 2019/2020.
9. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Bujqësi për përfundimin e korrje-shirjeve.
10. Inicimi i procedurave për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Transparencën në Komunën e Malishevës.
11. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/477 datë:23.08.2019 e parashtruar nga Kryesuesi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për mbështetje financiare për funksionalizimin e Bordit të Drejtorëve të NPK “ Stacioni i Autobusëve” SH.A në Malishevë.
12. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/468 datë: 16.08.2019 e parashtruar nga Kryesia e fshatit Carrallukë, për ndërtimin e rrethrotullimit në vendin ku kryqëzohet rruga “Hilmi Hoti” me trasenë e transitit.
13. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/471 datë:20.08.2019 e parashtruar nga Kryesia e fshatit Llazicë, lagja Buzhala, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shtëpisë (odës) së pritjes për komunitetin e lagjes Buzhala dhe për ndërtimin e parkut.

14. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/436 datë:12.07.2019 e parashtruar nga zj. Lumturije Berisha nga fshati Drenovc, për mbështetje financiare për shërim.
15. Shqyrtim i kërkesës nr.06/67 datë: 17.06.2019 e parashtruar nga z. Kaqanik Balaj nga Komuna e Istogut për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në zonën kadastrale në fshatin Mleqan KK. Malishevë.
16. Shqyrtim i kërkesës nr.02/445 datë: 18.07.2019 e parashtruar nga z. Egzon Gashi nga fshati Ngucat për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
17. Të ndryshme.

Mbledhja mbahet me datë 30.08.2019 dhe filloi në ora 10:39 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 19 asambleistë, Kryetari, drejtorë komunalë, përfaqësuesi i OSBE-së, LMT dhe media.

Rrahim Morina: Pershendetje për të gjithë! E hapi mbledhjen e IX-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Malishevës duke shpresuar që keni kaluar mirë në pushimet verore. Kërkoj që të respektohet Rregullorja e Punës së Kuvendit sepse kemi shumë pika të rendit të ditës. E hapi debatin për temën jashtë rendit të ditës.

Avdi Morina: Pershendetje për të gjithë! Kam dy çështje për të ngritur. E para, Kryesues materiali për këtë mbledhje na ka ardhur dje, pra nuk është respektuar afati 7 ditor dhe sipas procedurave ligjore nuk duhet të vazhdojë seanca. Kjo është një papërgjegjësi e Zyrës së Kryesuesit.

E dyta ka të bëjë me pagesat e meditjeve. Kryesues një pjesë e madhe e asambleistëve të NISMA në muajin e kaluar nuk janë paguar dhe në këtë muaj një pjesë e tyre nuk është paguar meditja. Kryesues nuk mund të merrni këso vendime arbitrare sepse për çështje politike ne në pikën e 3 apo 4 e kemi lëshuar sallën. Nuk dua që situatat e tilla të përsëriten.

Rrahim Morina: Ne materialin të premten e kemi pasur gati dhe e dorëzojmë në Drejtorinë e Adminstratës pastaj ata e shpërndajnë dhe përgjegjësia e shpërndarjes bie mbi ta. Më vjen keq për këtë që paska ndodhur dhe besoj që në të ardhmen nuk do të përsëritet kjo!

Sa i përketë pagesës të gjitha ata që nuk kanë qenë të pranishëm në atë mbledhje u është ndaluar meditja në përjashtim të Luanit i cili ka qenë pjesë e takimit.

Avdi Morina: Kërkoj nga Sekretari e Kuvendit që t'na jep gjendjen reale në mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit nga anëtarët e Asamblesë ku janë edhe gjirimet dhe nëse është ndryshe nga ajo që thuani ju ne do t'i ndjekim procedurat ligjore.

Sylë Dukolli: Pershendetje për të gjithë! Kam për t'i ngritur dy çështje. E para ka të bëjë me materialin. Materiali mua mka ardh të Enjëten e që ma kanë lënë një lokal afër sepse janë mësuar

ta lënë ashtu. Çka është më interesantja në zarf nuk ka pasur emër pra pa adresë. Kjo çështje do më shumë seriozitet pasi që jemi anëtarë të Asamblesë.

Çështja e dytë është sepse kam disa vërjetje për investimet që po bëhen, pavarisht që po gëzohemi për ato investime. Disa projekte në fshatin tim po devijohen, vijnë deri te xhamia e aty e pastaj shkojnë dikah tjetër siç është rasti i ndriçimit publik dhe shtrimi i disa rrugicave. Mendoj që projektet duhet të rrjedhin ashtu siç i kemi votuar këtu.

Rrahim Morina: Unë jam i gatshëm jo 7 ditë por edhe 10 ditë përpara ta bëjë gati materialin por problem është në grumbullimin e materialit për pikat e rendit të ditës nga drejtorët. Nëse konsideroni që materialin e keni marrë shumë me vonesë ne mund ta shtyejmë mbledhjen e vendosim si të doni. Nëse drejtorët ma dorëzojnë materialin sipas planit të punës prej datës 1 deri me datën 10 ju materialin çdo herë mund ta merrni me kohë.

Ilaz Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Kam vërjetje për devijimin e projekteve e sidomos te ai i ndriçimit publik sepse nuk ka shkuar ashtu siç është planifikuar.

Kam një kërkesë nga lagjia “Balaj” për rrugën “Ragip Latifi” kështë marr vendimi për shtrimin e asaj rruge 600m nuk është paraparë kanali për kodrinën që mbledh ujë që mbronë rrugën dhe shtëpitë që t’ju futet uji mbrenda. Këta qytetarë ju kanë drejtuar drejtorit të Inspektoriatit dhe të Urbanizmit për këtë çështje por rruga është shtuar por ky problem nuk është zgjidhur. Ne jemi takuar me Nënkryetarin Hajdin Berisha dhe ka premtuar që kjo çështje për 3 ditë do të kryehet por ka kaluar më shumë se 1 muaj dhe nuk është marrë asnjë hap për këtë çështje.

Ka shumë herë që e ngriti çështjen e kanalizimeve për Carrallukë. Përsëri ka probleme me rrjedhjen e tyre mbi tokë e që infetkojnë ujin e pijshëm.

Hashim Vrenezi: Pershendetje për të gjithë! Kam një shetësim të qytetarëve për rrugën nga Malisheva që shkon për Dragobil e që janë vendosur dy pengesa që janë jashtë standardeve. Sipas informatave nëse vendosen pengesa duhet të jenë 80cm të gjëra dhe 5 cm të larta jo aso çfarë ju i keni vendosur. Pengesa të tilla ka edhe në Banjë në lagjen “Telaku” ku inspektorët kanë dhënë urdhër që të hiqen ato pengesa e që realisht nuk janë hequr edhe pse janë jashtë standardeve.

Shqetësimi tjetër është lidhur me Planin e Prokurimit që e keni sjellur me disa afate kohore që është dashur të respektohen në kryerjen e punimeve. Në fshatin Marali me 23.04.2019 është e specifikuar asfaltimi i rrugës dhe me 13.05.2019 rregullimi i parkut të fshati por këto projektet as që janë hapur ndonjë tender për to. Përveç që po vonohen, devijohen këto projekte nuk po kryhen sipas paramasave dhe parallogarive që parashihen.

Ali Morina: Pershendetje për të gjithë! Në fshatin Astrazup në rrugën “Avdullah Morina” me buxhet është planifikuar që të bëhen 500m kanalizim. Ai kanalizim ka filluar, ndërsa Nënkryetari ka urdhëruar që të tërhiqen nga aty dhe ka ndalur punën. Qytetarët në formë proteste i kanë bllokuar mjetet e punës. Ai projekt është ndërprerë për 150m dhe sot e asaj dite nuk kanë

vazhduar punimet aty. Me çfarë të drejte i ka ndal punimet Nënkrjetari aty dhe e ka urdhëruar operatorin që të punojë në një vend tjetër? Kur do të përfundojë ajo rrugë së shtruar Kryetar? Shqetësimi tjetër është për punimet për ujësjellës nga Hidroregjioni aty ku prishet rruga dhe trotuari nuk po i kthejnë në gjendjen e mëparshme. Një dëmtim i trotuarit i shumë është para zyrës së subjektit të NISMA, nuk e di si nuk e ke vë re këtë Kryetar?! Ja ku është foto-ja dhe uroj që t'i merrni masat e duhura për këtë.

Kastriot Berisha: Pershendetje për të gjithë! Mendoj që Komuna e Malishevës ka shqetësime më të mëdha kolegj të NISMA se sa çëshjta se kur ka kardhur materiali sepse dis anga ju këtu i hapet zarfat.

Kryetar a nuk patet kohë tjetër që t'i ndreqni disa nga gropat nëpër asfalt apo veç në kohën kur vijnë mërgimtarët?! Këto gropa është dashur të ndreqen 2-3 muaj përpara.

Shqetësuese është edhe derdhja e kanalizimeve në Ujvarën e Mirushës edhe pse ne e mbajmë në logu të komunës.

Shqetësuese është kanalizimi në Gurbardh i cili derdhet te shkolla, e në disa lagje tjera. Nënkrjetari çdo herë kalon andej ama nuk e sheh, sepse nuk do me pa.

Çdo centimetër i devijuar i projekteve që është paraparë me buxhet e nuk shkon ashtu ne do të ngrisim padi në gjykatë.

Nebih Bibaj: Pershendetje për të gjithë! Me buxhet është paraparë që në Lladroc nga shkolla e vjetër deri te lumi diku 500m kanalizim ama ky projekt nuk është kryer.

Zhveshtoret dhe nyjet sanitare në stadiumin "Liman Gegaj" janë në gjendje të mjerueshme dhe do të ishte katastrofale me ardh ndonjë ekip jashtë malishevës e me i pa në atë gjendje.

Në mirëmbajtjen e rrugëve në projekt buxhet janë të ndara 50,000.00€, por kudo nepër fshatrat e K. së Malishevës ka gropa dhe këputje të asfaltit. Gjendja më e keqe e rrugës nga lëvizja e asfaltit dhe gropat është në qendër të Malishevës nga "Landi" e deri te "Rrethi".

Një tjetër shqetësim i imi ka të bëjë me vonesën në kryrjen e projekteve. Rruga "Agim Çela" ka 6 vite që është në projekt e nuk është shtruar edhe pse e ke premtuar në vitin që e ke marr pushtetin.

Hidajete Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Kryetar, ka shumë shqetësime nga qytetarët si për shembull në Komitetin për Komunitet u paraqit një shqetësim për një deponi të mbeturinave në Stapanicë. Ajo tani është mbyllë por telat e rrymës ka mbetur për tokë. Në Stapanicë nuk ka as ujë të pijëshëm. Në Kjevë gypat janë, por ujë s'ka. Është mirë që në bxhetin e ardhshëm të zgjidhet çështja e ujit për të gjithë banorët sepse uji është jetik.

Në buxhet është ndarë që në Kjevë të bëhet ndriçimi, nuk është bërë. Në Kjevë është dashur të punohet edhe kanalizimi por ky projekt ende nuk është kryer.

Lumi Mirusha i cili kalon nëpër Malishevë është në gjendje katastrofale nga pakujdesja dhe mosmirëmbajtja e tij. Nëse i frekuentojmë ato biznese apo kaffetri buzë lumit e shihni se sa kundërmonë andej pari dhe është turp në gjendjen në cilën është ai lum.

Kam një kërkesë nga qytetarët e lagjës “Mekaj” që t’ju mundësohet çasja në zabelet e tyre sepse për shkak të tranzit çasja ka mbet shumë lart dhe është e pamundur për kyqjen në pronat e tyre.

Rruga “Ëiliam Voker” është e asfaltuar deri te ferma e Mazrekëve dhe kam kërkuar që të lidhet me minitransitin afërsisht është 1650m sepse nëse shtrohet edhe ajo pjesë mund të shkarkohet komunikacioni nga rruga kryesore Rahovec-Malidhevë dhe Banjë-Malishevë.

Raimonda Krasniqi: Pershendetje për të gjithë të pranishmit! Dua të flas për një çështje lidhur me përgjigjien që ka dhënë drejtoresha e Drejtorisë së Kulturës, Besarta Kryeziu. Do të doja që ajo të ishte këtu. Mbas kërkesës sonë për veprimet e paligjshme që janë bërë në dhënien e parave për OJQ të cilat kanë konkuruar me projekte. Në pikën që është paraqitur që tri OJQ me numër 6, 12 dhe 18 janë gabime teknike. Unë e kam para vetës një prej këtyre 3 projekteve, d.m.th që nuk janë gabime teknike projektet të cilat nuk figurojnë aty, por janë projekte të cilat janë hequr në mënyrë të qëllimshme prej Drejtorisë së Kulturës, prej drejtoreshës. Nëse drejtoresha nuk ka qenë prezente dhe i kanë ardh emrat në zarf dhe nuk ka dijeni atëherë më vjen keq sepse është e vetmja femër që është në ekzekutiv dhe duhet të tregojë performancë të shkëlqyer dhe jo t’na shkel dinjitetin, krenarinë e ne të tjerave.

Para vetes e kam projektin me numër 12 gjë që drejtoresha na ka thënë që është gabim teknik.

Arlind Morina: Pershendetje për të gjithë! Në mbledhje e kaluar e kam ngritur një shqetësim për ndriçimin publik që është dëmtuar nga të reshurat atmosferike dhe nuk e di a jeni dal në terren dhe a keni parë gjendjen e tyre.

Shqetësuese është dita e perurimit të Memorialit të Masakrës së Burimit ku goxha merrshi hazë në përurim, në prerjen e shiritit, por pas disa ditësh shqetësuese është mirëmbajtja e tij sepse të gjitha fidanet që janë mbjellur e që simbolizojnë të vrarët, të gjitha janë tharë.

Kryetar, edhe juve edhe Hidroregjionit ju kam drejtuar me kërkesë një gyp që duhet të shtrihet në lagjen e “Krasniqëve”, saktësisht në rrugën “Qarri” sepse me buxhet është paraparë që ajo rrugë sivjet të shtrohet dhe për të mos u punuar 2 herë në atë rrugë kam kërkuar që të shtrihet gypi i ujësjellësit më parë.

Alban Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Kam një shqetësim nga bizneset e fshatit Kjevë sepse ata punojnë me gjeneratorë sepse rryma është tepër e dobët. Meqenëse K.e Malishevës ka mirëkuptim me KEDS-in dhe ai nuk paguan qera përvendosjen e trafostacioneve mendoj që është mirë ju Kryetar t’ju drejtoheni me një kërkesë KEDS-it për rregullimin e kësaj çështje dhe të shpëtojnë ato biznese.

Disa herë e kam ngritur çështje për vendosjen e pengesave në rrugë në hyrjet e qytetit për shkak të rrezikshmërisë së lartë në komunikacion. Nënkryetari ka thënë këtu që nuk kanë të drejtë për vendosjen e pengesave ngase leja duhet të merret nga Ministria e Infrastrukturës, ndërsa në rrugën “Ibrahim Mazreku” janë vendosur dy pengesa jashtë standarteve të kërkuara.

Gjendja e papastërsisë në qytetin e Malishevës është shkallë të lartë, çdo ditë i shihni mbeturinat në rrugë kam frikë që fëmijët që kalojnë aty pari mund të marrin edhe ndonjë infeksion. Nuk e di a po vepron inspektorati dhe a është kjo mospërgjegjësi e Ekoregjionit.

Edhe vitin e kaluar edhe sivjet është e paraparë me buxhet rregullimi i i pjesës në të dy anët e lumit në drejtim të urës së tranzitit, pse s'po fillon ky projekt Kryetar?

Kanalizimi në lagjën e "Samadraxhëve" ka filluar me buxhetin e vitit të kaluar dhe ende nuk ka përfunduar. Pse nuk ka përfunduar ende ky projekt Kryetar?

Deponia e bërlllogut në lagjën e "Hotëve" është e tmerrshme dhe është mirë që të bëhet një plan për shpërngulejen e asaj deponie nga aty sepse është me rrezikshmëri të lartë.

Kryesues, çështjen e Pishinës Gjysmëolipike e kemi përcjellë për dy drejtori komunale për çështjen e lokacionit neve nuk na ka ardhur sqarimi nga ato drejtori por as nuk ka ardhur si pikë e rendit të ditës.

Çështja tjetër ka të bëjë me ndërtimin e kullës së Sef Mleqanit të cilën e kemi miratuar në parim por ka mbetur që të skicohet sipërfaqja pastaj të votohet në tërësi.

Kam një pyetje për drejtorin e Finacave. Në fshatin Banjë e keni përmendur Valon që KPF-ja ka marr vendim për ndarjen e disa mjeteve finaciare, ndërsa këtu keni thënë që KPF-ja s'ka të drejtë të ndaj mjete finaciare. Kryesues dhe Valon, a ka të drejtë KPF-ja të ndaj mjete finaciare sipas rregulloreve në fuqi?

Për të gjithë ata që dalin në pension e që punojnë në institucione publike është ndarë një shumë mbi 100,000,00€, por sot e asaj dite asnjë nga këta puntorë që janë dal në pension nuk i kanë marrë 3 pagat përcjellëse. Mbase këta nuk i kanë marrë pagat, ku kanë shkuar ato para?

Luan Kryeziu: Pershendetje për të gjithë! Jam mirënjohës për punën e Kryetarit që është duke e bërë dhe çdo herë është afer qytetarëve! Kur po i dëgjoj disa shqetësime nga kolegët e mi këtu pom duken sikur të ishin "shqetësime imagjinare" nga opozita.

Dua ta falemnderoj kryeministrin në ardhje Fatmir Limaj për investimet që ka sjellë në Malishevë siç janë: tranziti, objekti për banim social, inkubatori i biznesit, shkolla këtu afër që po ndërtohet etj.

Kryesues, për thirrjen e mbledhjes nuk keni përfillur procedurat ligjore sipas nenit 43, pra po flas për datën kur është thirr mbledhja dhe leje çështje që materiali na ka ardhur pra 2 dite.

Kryesues në cilin ligj apo rregullore je thirrur që ju ke ndalur meditet disa asambleistëve?

Raimonda Krasniqi: Nëse Luanit i duken imagjinare projkti që 6-7 qytetarë të shkolluar e përgatisin në interes të fëmijëve tanë për edukimin, sigurinë e tyre, atëherë duhet të themi që Ekzekutivi në Malishevë është bastarduar.

Alban Krasniqi: Nuk ka asnjë projekt që ka vu dorë Qeverisja Begaj në të cilin nuk ka korrupsion, punime jashtëzakonisht të dobëta në të cilat nuk është intervenuar menjëherë siç janë shkollat në Lladroc, Bardh, Panorc, Burim etj. Mintranziti a e shihmi më çfarë gjendje është dhe cila është përgjegjësia që e ka marrë Qeverisja Begaj? Tani Memoriali që është bërë në Burim

për të kemi harxhu para publike, është dashur që edhe të kujdeseni për të. Dikush këtu e përmendi deponin e bërlllogut e cila është ilegale dhe këta kën marr kërkesë nga qytetarët dhe çdo sekondë i funksionimit të asaj deponie tregon që ju jeni njerëz që lejoni ilegalisht të funksionojnë gjërat dhe jeni përgjegjës që po lejoni dotjen e Malishevës. Merr vendim nëse ke guxim Kryetar për këtë çështje, nëse s'ke guxim lëshoja vendin atyre që kanë guxim që të marrin vendime.

Tjetra që 3 muaj i kemi ndarë mjetet për të sanuar një fermë, ndërsa Kryetari po e ndalon këtë vendim.

Kastriot Berisha: Kryetar, jam detyruar që fëmijët e mi t'i tërheq nga mësimi në Malishevë e i dërgojë në shkollë në Fushë-Kosovë për shkak të kushteve të dobëta që ka shkolla në Malishevë dhe cilësisë së ultë në arsim.

Është e turpshme gjendja në arsim në Malishevë veç shihni gjimnazin "Hamdi Berisha" çfarë profesorë kishte dhe çfarë ka sot sepse po i punësoni të gjithë më të njofshëm dhe militantë partie.

Ja tërheqi vërejtjen atij profesori që e keni çu në shkollë profesionale i cili foli e nuk e dinte për çfarë është tema e nuk e dinë për çfarë flet.

Demir Bajraj: Pershendetje për të gjithë! Nuk është mirë që ne si Asamble Komunale të përdoret gjuha e vrazhdë dhe fyese. Është mirë që të kritikojmë në gjuhën e njerzisë ashtu siç na ka hije dhe t'i mbrojmë interesat e qytetarëve.

Kryetari- Ragip Begaj: Pershendetje për të gjithë! do të mundohem që t'ju përgjigjem juve për pyetjet dhe kërkesat e juaja.

Niveli i Asamblesë gjithëmonë është duke ardhur më i ultë sepse nga legjislatura e parë jam këtu. As rruga, shkolla, ndriçimi apo çfarëdo investimi nuk bëhet për një subjekt politik por për të gjithë qytetarët.

Sylë, ka pas raste kur jam rrezikuar vet e kam bërë devijime të projekteve për të mirën e qytetarëve dhe në bashkëpunim me kryetarët e fshatrave. Rruga që është devijuar në Bubavec është bërë edhe me pëlqimin e qytetarëve aty dhe të kryetarit të fshatit sepse rruga ka qenë shumë e ngushtë dhe nuk e ka zënë makinerinë dhe kemi rënë dakort që ajo të shtrohet me kubëza.

Rrugën "Ragip Latifi" e kam shikuar vetë pas shtrimit të asfaltit dhe ka shkuar sipas projektit, kanali nuk ka qenë në projekt dhe nuk ka dashur ta bëjë kanalin pa projekt.

Me kërkesën e qytetarëve i kemi vendosur dy pengesa në lagjeën e "Gurit" në rrugën kryesore dhe kemi kërkuar një pëlqim nga Ministria e Infrastrukturës për këtë. Ato kushtojnë dhe nëse i parashihni që duhet të ketë edhe të tjera është mirë që të futen në buxhet për vitin e ardhshëm.

Rruga në Marali është në plan me këto procedura që janë tani dhe së shpejti do të shtrohet Hashim. Ashtu në procedurë është edhe rruga "Abdullah Morina" ju as nuk po lini që t'ju përgjigjem me këto ndërhyrjet nga vendi, edhe pse i kam shkruar përgjigjet e juaja.

Kastriot, është mirë që mos ta rëndonin askë me fjalë sepse ne po lëvizim nëpër parit si ti që deri dje ke qenë në PDK e sot je në AAK kështu të lëmë vend për takime. Kastriot ke të drejtë kur thua që rrugët po shtrohen në kohën e gurbetxhinjëve por ato rrugë ka qenë duke i shtruar Ministrria dhe një reagim sikur ti e kam bërë edhe unë duke ju bërë presion që të kryhen ato sa më shpejtë.

Shqetësim edhe i imi është çështje që ujërat e zeza derdhen në lum këtë çështje e kam ngritur edhe në Ministri për punimin e impiantit ku derdhen ujërat e zeza. Janë përfunduar qytetet e mëdha ndoshta po i vjen rendi edhe Malishevës tani. Është mirë që të merret një vendim e të ndahen mjetet me buxhet për renovimin e kanalizimeve.

Nebih ku është në pyetje kanalizimi në Lladroc? Te shkolla e vjetër. Ajo qenka në projekt buxhet.

Ju po i drejtoni të gjitha çështjet për rrymën tek unë. Unë s'kam asnjë përgjegjësi për këtë. Ai është institucion i pavarur dhe nuk na përgjigjet neve. Por unë sa kam ndikim ndajm tyre aq ju drejtohem.

Arlind sa i përketë "Memorialit të Masakrës së Burimit" s'ke të drejtë të më kritikosh por të më lavdosh për atë punë që kam bërë, ju vet fshati duhet të kujdeseni për mirëmbajtjen e atij memoriali.

Unë u mundova t'ju përgjigjem pyetjeve të juaja, kërkoj falje nëse e zgjata shumë.

Rrahim Morina: Është mirë që ta aprovojmë rendin e ditës pastaj të shkojmë në pushimin e drekës. Para se me hap debatin për rendin e ditës, Kryetari ka kërkuar që në rendin e ditës të futen edhe 2 pika.

1. Kërkesa nr. 01/1152 e dt. 08.08.2019 për ndarjen e loacionit për ndërtimin e zyreve të shoqatave të dalura nga lufta. Kjo çështje është diskutuar disa here.
2. Rapori i Zyrës së Kryetarit dhe i Qeverisë Komunale për periudhën janar-qershor 2019. Ky material ka ardhur pas shpërndarjes së materialit për këtë mbledhje, prandaj që ky duhet të shqyrtohet e të analizohet e ne nuk kemi kohë prandaj kërkoj që ta lëmë për një mbledhje tjetër. Kam edhe dy kërkesa unë. Janë dy vendime që ka kërkuar MAPL-ja të anulohen vendimi për marrëveshjen me "Shën-Terezën" dhe sindikatat e arsimit. Ministria shkresën e kanë kthyer kinëse kjo është punë e Kuvendit e duhet të shkoj përmes akandit. E kjo është shumë problematike. Prandaj ne duhet t'i anulojmë këto dy vendime sot, e më pas shohim e bëjmë. E hapi debatin për rendin e ditës është mirë që të shkojmë me deklarime të shefave të grupeve.

Sylë Dukolli: Mendoj që këto të hedhen në votim secila pikë një nga një.

Alban Mazreku: Grupi ynë e përkrah veç rendin e ditës që është thirrur mbledhja, d.m.th nuk e pranon asnjë pikë tjetër të futet në rendin e ditës.

Arlind Morina: Ne grupi ynë e përkrahim kërkesën për shoqatat e dalura nga lufta dhe anulimin e vendimeve ndërsa Raportin e Kryetarit duhet lënë për një ditë tjetër.

Alban Krasniqi: Mendoj që u dakroduam që Raportin e Kryetari ta lëmë për një ditë tjetër e sa e shpejtë të jetë mundur shkaku që është voluminoz e do analizuar. Sa i përket pikës për shoqatat e dalura nga lufta pajtohemi që të hynë në rendin e ditës. Sa i përket këtyre anulumimeve të vendimeve ja bëjmë si të doni, ne jemi të hapur për të diskutuar.

Rrahim Morina: Atëherë shkojmë në votim një për një. Shkojmë në anulimin e vendimeve.

Muharrem Morina: Pershendetje për të gjithë! Pse është e rëndësishme që të shfuqizohen këto vendime sepse MAPL-ja dhe ligji e autorizon Kuvendin që mbrenda 1-muaji të shfuqizohen. Në kohën e pushimeve e kemi kaluar dhe e kemi tejkaluar këtë afat ligjor dhe MAPL- e ka kërkuar nga Ministria e Drejtësisë që neve t'na paditin në gjykatë për vonesën e këtyre dy vendimeve. Nese ne i shfuqizojmë e njoftojmë Ministrinë dhe padia tërhiqet nga fukcioni e të mos bëhemi objekt për mediat për një çështje që nuk është shumë serioze, prandaj është e nevojshme sot t'i shfuqizojmë këto dy vendime.

Rrahim Morina: Po e lexoj. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit Komunal nr.02/402 i datës 04.07.2019 që e autorizon Kryetarin e Komunës të lidh marrëveshje me Sindikatën Komunale të Arsimit Parauniversitar në K. e Malishevës për ndryshim të zyreve për ushtrimin e veprimtarisë së tyre sipas kërkesës së MAPL-së nr. 020-790/11 e datës 22.07.2019, pra kërkohet shfuqizimi i vendimit. Kush është pro që të futet në rend dite kjo pikë?

Për: 22 (unanimisht)

Tjetra është: Rishqyrtimi i vendimit me nr.02/403 i datës 04.07.2019 që autorizon Kryetarin e Komunës të lidh marrëveshje me shoqatën bëmirese "Shën-Tereza" për ndarjen e zyreve për ushtrimin e veprimtarive të tyre. Sipas kërkesës së MAPL-së nr.020-790/12 e datës 22.07.2019. Kush është për që kjo pikë të futet në rendin e ditës?

Për: unanimisht

Kalojmë te Kërkesa e Kryetarit 01/1152 e dt. 30.08.2019 për ndarjen e loacionit për ndërtimin e zyreve të shoqatave të dalura nga lufta. Kush është për që të futet në rendin e ditës?

Për: unanimisht

Tjetër është: Raporti i Zyrës së Kryetarit dhe i Qeverisë Komunale për periudhën janar-qershor 2019. Mirë po kërkoni që të jetë si pika e fundit e rendit të ditës. Kush është për?

Për: unanimisht

A ka mundësi që këto 3 kërkesat e para që të jenë menjëherë pas procesverbalit? Kush është për?

Për: unanimisht

Atëherë shkojmë në votim në tërësi të rendit të ditës me plotësime. Kush është për?

Për unanimisht

Me votim unanim aprovohet rendi i ditës. Shkojmë në pauzën e drekës, kthehemi pas 1 ore.

Pas pauzës së drekës fillojmë me pikat e rendit të ditës. Të pranishëm jemi 17 dhe kourrum kemi.

Pika e 1-rë e rendit të ditës është: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e VI-2019. E hapi debatin për këtë pikë. Mbase s'ka diskutues, kush është pro aprovimit të këtij procesverbalit?

Për: unanimsisht

Kalojmë në pikën e 2-të të rendit të ditës: Shfuqizimi i vendimit i vendimit të Kuvendit Komunal nr.02/402 i datës 04.07.2019. Kush është për?

Për: unanimsisht

Kalojmë në pikën e 3-të të rendit të ditës: Shfuqizimi i vendimit të Kuvendit të Komunës me nr.02/403 i datës 04.07.2019. Kush është për?

Për: unanimsisht

Kalojmë në pikën e 4-ërt të rendit të ditës: Kërkesa e Kryetarit nr. 01/1152 e dt. 80.08.2019 për ndarjen e një lokacioni për ndërimin e zyreve për shoqatat e dalura nga lufta. E hapo debatin për këtë pikë.

Hidajete Mazreku: Ju e dini që kjo parcelë ka pasur kontest gjyqësor. Në mars më duket i kemi shpallur me vendim tonin 7 ari aty për interes publik për Qendren për Paisje me Dokumente. Edhe atëherë kemi votuar kundër ligjit sepse kjo pjesë e tokës është e AKP-së. Me Ligjin 04/L144 për Këmbimin e Pronave, këto parcela mund të shpallen zonë e interesit nëse janë pronë e komunës, jo e AKP-së. Së pari ne duhet të marrim pëlqimin nga AKP-ja për zonën që kërkohet të shpallet zonë e interesit. Prandaj po them që kjo sot është kundër ligjit edhe kjo pjesë për 5 ari dhe është në kontest gjyqësor në Dhomën e Posaqeme. Unë nuk jam kundër shoqatave të dalura nga lufta por nuk dua të jem pjesë e diçkaje që është e kundërligjshme. Askush nuk është mbi ligjin.

Sylë Dukolli: Une jam i lumtur që sot do të ngris dorën pro diçkaje që është dashur të bëhet me kohë, ndërsa ato që tha profesoresha është një sektor tjetër që merret me ligjin dhe ne nuk e kemi në përgjegjësi. Nëse janë ndarë 7 ari në vitin e kaluar aty për ndërtimin e Qendrës për paisje me dokumente pse mos të ndahen edhe 5 ari sot për shoqatat e dalura nga lufta. Ne këtë kërkesë e mbështesim në mënyrë unanime.

Ali Morina: Ne PDK-ja e mbështesim këtë kërkesë për shoqiata e dalura nga lufta sepse mjaft është zhaguar kjo punë dhe ka pasur kohë të mjaftueshme për të sqaruar anën ligjore për pronën.

Arlind Morina: Edhe ne Grupi i LDK-së e mbështesim këtë kërkesë.

Ilaz Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! kjo kërkesë është bërë më shumë se një vit nga ne Komisioni i Familjeve të Dëshmorëve dhe Veteranëve të Luftës për ndarjen e një loacioni për shoqatat e dalura nga lufta dhe ta kenë një adresë për punën e tyre. Kërkoj që nga të gjithë ju që kjo kërkesë të votohet unanimsisht.

Alban Mazreku: Ne në vitin e kaluar kemi pas marrur një vendim të tillë edhe për Qendren për Paisje me Dokumente por deri më sot nuk është marrë asnjë hap për realizimin e atij projekti. Kërkoj që edhe sot t'i bëhet përkufizimi i saktë mbrenda fletës poseduese loakacioni që do të ndahet dhe të obligohet Drejtoria e Kadastrës që t'i bëhet skica e pronës në fjalë ku do të ndërtohet.

Si qytetar i Malishevës e di që është një kontest gjyqësore në mes të bashkëqytetarëve të mi dhe AKP-së kjo pronë dhe personalisht do të votojë kundër jo për shoqiatat e dalura nga lufta por në raport me kontestin që kanë këta qytetarë me AKP-në.

Rrahim Morina: Pas debatit shkojmë në votim. Kush është për që të miratohet kjo kërkesë?

Për: 18

Kundër: 2

Abstenim: 1

Me këtë votim aprovohet Kërkesa për ndarjen e lokacionit për shoqaiatat e dalura nga lufta.

Kalojmë në pikën e 5-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/125 datë:10.07.2019, për rritjen e buxhetit të hyrave vetanake për vitin 2018. Kjo nuk është bartje por rritje tash do t'u sqaron drejtori këtë.

Valon Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Kryesuesi ka diskutuar me mua dhe i ka ngritur ato dilemat se si mund të rritet në vitin 2019 buxheti i vitit 2018. Realizimi i buxhetit në termologjinë ekonomike përkatsisht të kontabilitetit përdoret përparimi i keshit, paret që vijnë shpenzohen në atë moment e jo për periudha të ardhshme. Mbi bazën e këtij parimi dhe baza tjera gjat vitit 2018 kur e kemi paraqitur raportin finaciari kemi deklaruar që buxheti i të hyrave vetanake i vitit 2018 e ka tejkaluar për 1.18% planifikimin. Ky 1.18% është në vlerë montare 9690.12€ dhe këto të hyra janë realizuar në vitin 2018 dhe i përkasin viti fiskal 2018.

Më planifikimin e buxhetit për çdo vit planifikohen edhe të hyrat vetanake nëpër drejtori dhe shpërndahen nëpër projekte të ndryshme. Pra për të pasur mundësi për të shpenzuar rritjen dhe për ta menaxhuar buxhetin e viti 2018 ne duhet të rrisim një projekt kapital prej të hyrave vetanake të vitit 2018 dhe me vendim të Asamblesë mbarten nga i njëjti projekt për projektet tjera. Prandaj e kam bërë kërkesën për rritjen e të hyra dhe e kam specifikuar në cilin kod të rritet përkatësisht.

Rrahim Morina: Me aq njohuri që kam edhe pse nuk jam ekonomist e di që ka mundësi për bartjen e mjeteve, veq për rritjen e buxhetit për vitin që ka kaluar as për të hyrat vetanake kurrë nuk e kam dëgjuar edhe pse ka kaq vite që jam këtu në Asamble. Prandaj vota ime është kundër për një çështje që nuk e di. E hapi debatin për këtë pikë.

Muharrem Morina: Ky fenomen ka ndodhur vazhdimisht. Muajin nëntor dhe dhjetor të hyrat vetanake kanë ndodhur, ka pas të hyra edhe nga gjykata. Por këtë të hyra nuk kanë mundur që t'i shpenzojnë mbrenda vitit që hyjnë prandaj ju duhet që t'i bartni për vitin 2019 në këtë rast, por

duhet që t'i përcaktoni se në cialt kode duhet të shpenzohen. Në këtë formë Asambleja e ka miratuar me propozimin e Drejtorisë së Financave bartjen e mjeteve. Ne deri tani kështu kemi vepruar nëse ka dal diçka e re duhet patjetër të ketë mbrapa ndonjë ligj apo udhëzim administrativ.

Sylë Dukolli: Suficiti mund të quhet mbledhja e më shumë se sa e planifikuar e të hyrave vetanake që zakonisht ndodh në fund të vitit për shkak se të gjithë barazohen. Si pasojë e kësaj ky kod buxhetor është rritur e që është normale. Mendoj që kësaj çështje duhet një zgjidhje t'ja bëjmë e që është mirë që bartja e mjeteve të bëhet në një kod të veçantë për shpenzimet kapitale me projeksione. Mendoj që ju si Drejtori është mirë që t'ju drejtoheni Ministrisë së Financave për këtë çështje e të kemi edhe ne një informatë të sqaruar me shkrim sepse a ka pasur ndonjë rast të tillë edhe në komunat tjera. Nëse duhet të ngritet tavanin i vitit 2018 e që për mua është një dukuri e re, atëherë edhe ne veprojmë si të tjerët.

Hashim Vrenezi: Në qoftëse duhet ta respektojmë këshillën e drejtorit për të rritur tavanin e vitit 2018 atëherë ne po u dashka ta zvogëlojmë tavanin e vitit 2017 sepse jemi duke bartur 4,749€ të viti 2017 e realisht shpenzimi nuk ka ndodhur ashtu siç ka qenë planifikimi për inkasim. Mendoj që për këtë pikë është e panevojshme që të nxjerrim ndonjë vendim për këtë çështje.

Alban Krasniqi: Sipas diskutimeve po shihet qartë që rruga e vetme është që t'i drejtoheni Ministrisë së Financave që të jemi më të qartë edhe ne.

Valon Mazreku: Këtë që po kërkoj para jush që ta bëjmë jam i sigurtë 100%. Në rast që po kërkoj që të rritet tavanin i të hyrave atëherë unë kam biseduar me Ministrinë e Financave në mujin maj ose qershor.

Për të zvogëluar tavanin Hashim të vitit 2017 nuk ka nevojë sepse jodomosdoshmërisht planifikimi mund të jetë 100%. Ju saqrova me disa shembuj dhe është mirë që ta votoni.

Rrahim Morina: Falemnderit drejtor! Kjo çështje mbete që drejtori të kërkoj sqarime shtesë nga Ministria e Financave dhe pastoj kjo çështje të vi në Kuvend.

Kalojmë në pikën e 6-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/126 datë:10.07.2019, për bartjen dhe ridestinimin e mjeteve vetanake nga viti 2017 dhe 2018 në vitin 2019. Drejtori e ka fjalën.

Valon Mazreku: Kërkesën ju kam dërguar të qartë dhe të specifikuar për projektet që janë të nevojshme siç është ndërtimi i rrethit në rrugën "Ibrahim Mazreku" që lidhet me rrugën "Habib Berisha", renovimi i kanalizimeve nëpër fshatrat e komunës, vendosja e pengesave në rrugët e qytetit, renovimi i urave në Kërvasari, në Marali dhe Goriq. Të cilat i keni të specifikuar me të gjitha detajet në shkresën që ju kam sjellë.

Në bashkëfinacim me qytetarët një pjesë do të ndahet për lagjën “Hoti” në Malishevë, OJQ-të e ndryshme, rruga Rud-Sferkë, në shëndetësi. Edhe këto i keni të saçuara detajisht në shkresë.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Krasniqi: Po mendoj që rrethi më mirë do të ishte të ndërtohej te rruga e gjimnazit se atje lart edhe është mbrenda rrezes së qytetit. Rrethi do ta ndalonte shpejtësinë e makinave dhe do ta rregullonte komunikacionin në atë pjesë. Kostoja prej 20,000€ nuk e di sa është e arsyeshme sepse neve na ka ardhur veç shuma dhe emërtimi pra nuk ka donjë justifikim tjetër.

Sa i përketë renovimeve të kanalizimeve në takimet me qytetarët për buxhetin ata kane pasur kërkesa dhe ankesa të shumta për kanalizimet e dëmtuara dhe shuma është e vogël.

Nuk e di se si me 18,000€ mund të renovohen këto 3 ura e që mendoj që kjo shumë nuk është e mjaftueshme.

Sa i përketë bashkëfinancimit kërkoja nga Muharremi që t’na sjellë marrëveshjen për bashkëfinacim me “Jetimat e Ballkanit” sepse jemi duke folur për një shumë të madhe. Ne duhet të votojme me kushtin që shpenzimi i këtyre mjeteve dhe i shumës të bëhet pas shqyrtimit të kërkesave nga Komisioni që ne e kemi krijuar.

Ne një 10,000€ duhet ta heqim nga këtu deri sa ta marrim sqarimin nga Ministria e Financave për pikën që diskutuam më parë.

Shumën për 36,000€ te pagat dhe medijtjet ku po do ta bartësh Valon, këtë nuk e kemi të qartë?

Filloretë Bytyqi: Pershendetje për të gjithë! Renovimi i urave Kërvasari, Marali dhe Pagarushë 18,000€ mendoj që shuma e mejteve është shumë e vogël për rregullimin e këtyre urave.

Tereni te ne është i papërshtatshëm dhe ura duhet të ndërtohet e qëndrueshme sepse për shkel e shko ne nuk do të lejojmë si fshat prandaj kërkoj që shuma për ura të rriten e urat ndërtohen njëherë e përgjithëmonë e jo mbrenda vitit të ndërtohen për së dyti.

Alban Mazreku: Ne edhe vitin e kaluar e kemi bërë bartjen e të hyrave vetanake të 2017 në 2018, por pse nuk është bartja e asaj shumës 4,749.19€?

Te specifikimi, bashkëfinacim me qytetarët OJQ “Jetimat e Ballkanit” shuma është 25,000€, po GVL-të a hynsë në bashkëpunim me “Jetimat e Ballkanit” apo është veç? Atëherë a mund t’i ndajmë shumat?

Pra, 25,000€ bashkëpunimi me “Jetimat e Ballkanit”, 40,000€ me Ministrinë e Infrastrukturës. Na propozojmë që të hiqen nga bashkëpunimi me Ministrinë e Infrastrukturës 10,000€ dhe shuma që ka tepruar nga viti i kaluar e të shtrohet rruga që lidhet me rrugën “Agim Çela” ankesi i saj “24 marsi” 200 m të shtrohen me kubëza në fshatin Lladroc.

Paga dhe medijtje shuma është 36,000€, për çka është fjala?

Sadije Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Propozoj që këto bartjet e mjeteve t'i lëjmë për një takim tjetër në mënyrë që të shikojmë se kua nevojë më së shumti të investohen këto mjete. Jo sot të themi shkojnë këtu apo atje.

Alban Krasniqi: Parafolësja e dhe një propozim të arsyeshëm sepse në këtë kushte nuk jemi në gjendje që të marrim një vendim të duhur ndaj kërkesave që janë adresuar. Është fakt që nuk mjaftojnë 18,000€ për urat e raste të tjera. Prandaj është mirë që të bëhet një grup punues të merren me këtë çështje dhe të vimë në Kuvend me propozim konkret.

Propozoj që të rregullohet ai muri i çarë i shkollës në Vermicë dhe ai tepihu i fushesh që po rrinë të rregullohet e besoj që me 14,000€ kryhen këto punë. Është mirë që t'i diskutojmë këto çështje paraprakisht.

Rrahim Morina: Me të vërtetë është mirë që kjo çështje të shtyhet për një ditë tjetër e të zgjedhim rastin më emergjente siç janë urat sepse rrethi mund të presë.

Alban Mazreku kërkoj që të hiqen nga bashkëfinacimi për rrugën Rud-Sferkë 10,000€, por ajo nuk mund të ndodh sepse marrëveshja është e nëshkruar me 30% e që i bie që është ajo shumë, e aty asnjë cent nuk mund të hiqet.

Demir Bajra: Pershendeje për të gjithë! Mendoj që Drejtoria e Financave dhe e Urbanizmit e paskan përgatit këtë shkresë dhe mendoj që është mirë që ta votojmë si te tillë sepse me të vërtetë për këto investime kanë nevojë qytetarët, e të mos humbim kohë edhe më shumë.

Sylë Dukolli: Në fillim edhe unë isha që kjo çështje të shtyhet por duke e parë kohën në të cilën jemi dhe duke i ditur procedurat e prokurimit më mirë do të ishte që sot kjo çështje të zgjidhet.

Valon Mazreku: Këtu e kam vendimin e dt. 24.02.2015 të nxjerrë nga Kuvendi për rritjen e tavanit e të hyrave vetanake për vitin 2014. Së pari është bërë kërkesa nga D. e Financave për rritjen e tavanit, pastaj është bërë kërkesa për destinimin e të hyrave dhe është nxjerr një vendim i cili është dërguar për ligjëshmëri dhe ja ku është vendimi.

E paraqita ndryshimin. "Jetmiat e Ballkanit" i kanë 25,000€ te bashkëfinacimi, 35,000€ është bashkëfinacimi me Ministrinë e Infrastrukturës për rrugën Rud-Sferkë dhe përafërsisht 10,000€ të ndahen për rrugën që kërkoj Alban Mazreku e pjesa tjetër të jetë ashtu siç ishte.

Rrahim Morina: Alban Krasniqi po kërken 5 min pushim për një takim me shefat e grupeve për harmonizimin e këtyre investimeve. Atëherë nuk po pajtoheni për për pauzë, vazhdojmë pra.

Alban Krasniqi: Këto investime veç janë shpallë në prokurim kanë bërë shkelje, e tani kërkojnë nga ne që ta votojmë ashtu siç është. Ne LVV nuk e votojmë sepse e keni bërë shpalljen e projekteve pa e marrë vendimin e Kuvendit Komunal.

Valon Mazreku: Mbledhjen e fundit kanë qenë edhe këto dy pika por për shkak të kohës nuk janë trajtuar e për shkak të rastit emergjent ne e kemi bërë shpalljen për rregullimin e urës dhe jam ka të bindur që s'keni me qenë kundër. Rruga është e pakalueshme dhe ka qenë e domosdoshme të rregullohet ura.

Rrahim Morina: Shkojmë në votim dhe i hudhi në votim edhe propozimet e juaja.

Florentina Zulfaj: Kërkoj që me këtë bartje të mjeteve të paiset me nxemje qendrore edhe shkolla fillore “Visar Krasniqi” në Drenoc sepse është me stfua.

Valon Mazreku: Me gjithë propozimet që dhatë po pajtohem se të gjithë të kaloj kjo pikë. Atëherë prej kategorisë paga dhe medijtje te programi i shëndetësisë të hiqen 15,000€ etë kalojnë për nxemjen qendrore për shkollën fillore “Visar Krasniqi”.

Alban Krasniqi kërkoj që të rregullohet muri në Vërmicë 14,000€ përsëri nga prorgami i shëndetësisë. 2,000€ nga këtu i shtojmë për shumën e urave. Nga kjo shumë e programit për shëndetës i kemi edhe 5, 138€ dhe nga kjo shumë 3,000€ të shkojnë për gypin që kërkoj Arlindi gdhe 150m gyp të ujit për lagjen “Vataj” dhe fuksionalizohet edhe për atë lagje uji dhe 2,138.60€ të fundit shkojnë për kanalizimet. Pra të shëndetësia pagat u bënë 0.

- Rreth-rrrotullimi 20,000€
- Renovimi i kanalizimit nëpër fshatrat e K.së Malishevës janë 15,243.24€
- Vendosja e pengesa është 10,000€
- Renovimi i urave u bë 20,000€

Bashkëfinacimi:

- “Jetmiat e Ballkani” i kanë 25,000€
- Bashkëfinacimi i rrugës Rud-Sferkë me Ministrinë e Infrastrukturës i ka 35,000€
- 10,000€ u ndanë për rrugën “24 marsi” në Lladroc

Dhe ato që u nganë më lart nga pagat e nga programi i shëndetësisë.

Rrahim Morina: Të gjithë këtë që e tha drejtori e hudhi në votim. Kush është për?

Për: 21 (unanimisht)

Ne duhet ta mbajmë vazhdimin e kësaj mbledhje dhe e lëjmë për të Premten në ora 10. Falemnderit për pjesëmarrje dhe me kaq e shpalli të mbyllur pjesën e parë të mbledhjes.

Pjesa e I-rë e mbledhjes përfundoi në ora 16:10.

*

*

*

Vazhdimi i mbledhjes së X-të të rregulltë të Kuvendit të Komunës së Malishevës

Vazhdimi i mbledhjes mbahet me datë 06.09.2019 dhe filloi në ora 10:30 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 19 asambleistë, përfaqësuesi i OSBE-së, dhe media.

Rrahim Morina: Pershendetje për të gjithë! Po e hapi vazhdimin e mbledhjes së X-të të rregulltë ashtu siç jemi dakorduar dhe kourrum kemi mund të vazhdojmë me pikat e rendit të ditës.

Kemi mbetur te pika e 7-të e rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor i Drejtorisë për Shëndetësi për vitin 2019. Po, Raimondë.

Raimonda Krasniqi: Pershendetje për të gjithë të pranishmit! Kërkoj nga Drejtori i Arsimit se kur të vie pika e tij për të raportuar t'na sjellë edhe konkursin e arsimit për të gjitha shkollat në K. e Malishevës.

Rrahim Morina: Kalojmë pra te pika e 7-të e rendit të ditës, drejtori nuk qenka këtu apajtoheni që kjo pikë të shtyhet në mugesë të drejtorit. Pra kjo pikë shtyhet për një mbledhje tjetër në mungesë të drejtorit. Këtu nuk janë as drejtorët e tjerë edhe pse kemi shumë pika që duhet me raportu ata.

Alban Krasniqi: Kjo është për të ardhur keq për mos pranin e drejtorëve këtu. Drejtorin e Shëndetësisë para 20 min e takova në rrugë, veç nëse nuk janë të informuar që mbledhja mbahet sot.

Mendoj që kolegët nga Nisma duhet të bëjnë presion që drejtorët të jenë këtu sepse edhe ai i Financa duhet me qenë domosdoshmërisht këtu sepse na ka sjellë një listë prej 20 vetëve përfituese të 100€ për nënat lehona. Mendoj që duhet të ketë më shumë lindje në K.e Malishevës por ato nuk janë të informuara. Dua disa sqarime për këtë çështje.

Sylë Dukolli: Pershendetje për të gjithë! Kjo është vazhdim i seancës së X-të dhe ju e dini se shumica e drejtorëve kanë qenë këtu në javën e kaluar, por ne po e rëndojmë rendin e ditës me pika të shumta e debate të stërzgjatura.

Për të gjithë nuk mund të flas por disa nga drejtorët kanë pasur një takim në Prishtinë në subjektin e NISMA. Propozoj që pikat që kanë të bëjnë me drejtorët të shtyhen për një seancë tjetër sepse ato duhet të diskutohen me praninë e tyre këtu.

Rrahim Morina: Mua më ka kërkuar leje vetëm drejtori i Arsimit e Halimi si koordinator do ta përfaqësojë Drejtorinë e Arsimit. Mendoj që është mirë që t'i diskutojmë këto pika edhe pse drejtorët nuk janë këtu sepse qytetarët duhet të informohen për gjendjen rale në Malishevë.

Alban Mazreku: Pershendetje për të gjithë! U diskutua këtu edhe për nënat lehona por nëse e shikojmë këtë listë me emrat dhe vendet nga vinë pothuajse 90% janë përfitues ata që e votojnë NISMA. Tash nuk e di si janë informuar dhe cilat janë procedurat për përfituesit e kësaj ndihme. Nëse edhe këtu ka ndërhyrë politika me të vërtetë kjo është e turpshme.

Rrahim Morina: Atëherë veç hymë në temë po diskutojmë për pikën e 8-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i vendimit lidhur me pagesën për nënat për çdo fëmijë të lindur.

Arlind Morina: Pershendetje për të gjithë! Sa i përket vendimit për ndryshimin e shumë 100€ për nënat lehona një rast të tillë kisha edhe vet se u bërë prind për herë të dytë por kur kam ardhur këtu nuk e dija se cilat dokumente janë të nevojshme. Pra nuk janë të publikuara procedurat. Komuna është dashur që ta bëjë publike në faqen e komunës.

Avdi Morina: Pershendetje! Debatet jokonstruktive dhe këto mbledhje të stërzgjatura e bënë që të bie edhe interesimi për pjesëmarrje dhe si rezultat i kësaj po e shohim se si kemi gjendjen. Realisht vendimet janë marrë në mënyrë publike dhe janë publike prandaj nuk e di pse e diskutojmë këtë këtu. Ndoshta do të ishte më mirë që të gjindet një mënyrë tjetër për informimin e qytetarëve nga Drejtoria ama debati po banalizohet deri në këtë formë sa Albani po thotë se këto nëna janë të NISMA përfituese të kësaj shume. Procedurat janë të thejshta veç të dorëzohen këtë dokumente. Certifikata e lindjes së fëmijës, letërnjoftimi i nënës kopje, konfirmimi i bakës edhe kryhet kjo punë.

Ali Morina: Pershendetje për të gjithë! I nderuar, nuk po banalizohet kjo pikë e rendit të ditës sepse veç sa u konsultove me drejtorin para se të flasësh sepse as ju nuk ishit i njoftuar se cilat janë procedurat e marrëjes së kësaj ndihme.

Kryesues, ne duam të dimë se sa lindje ka pasur deri tani në K. e Malishevës, dhe pse janë përfitues të kësaj ndihme veç 20 persona?

Kërkojmë që njoftimi të jetë çdo vend në hapësira publike që qytetarët të jenë mirë të informuar.

Valon Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Kryesuesi na është drejtuar me një shkresë që të informoheni se cilët janë përfituesit nga vendimi i Asamblesë Komonale për lehonat. Unë ju ka dorëzuar një listë me emra të fëmijëve, emrat e prindërve dhe vendin nga vijnë. Gjithsej deri me tani janë 22 përfitues. Dokumentet e nevojshme janë: certifikata e lindjes së fëmijëve, kopja e letërnjoftimit të nënës dhe konfirmimi i llogarisë së bankës së nënës pasi që vendimi është për nëna.

Sa i përket saj se sa lindje kanë ndodhur në K. e Malishevës kjo nuk është kompetencë e imja dhe nuk kam informacion.

Hashim Vrenezi: Sa i përket kësaj përgjigjie kjo tregon që nuk ka ndonjë hartim të një procedure për këtë vendim. Realisht është dashur të jetë një procedurë e shkruar si formularë, pastaj dokumentet e nevojshme dhe të dorëzohet pastaj në zyrat përkatëse sepse është e

paarsyeshme që qytetari i shku e me kërk drejtorin e Financave për këtë çështje. Hartojeni një procedurë dhe kërkesat të dorëzohen të kërkesat.

Alban Krasniqi: Mosrregullimi i procedurave krijon automatikisht rrethana presioni te qytetarët dhe mosinteresim për këtë çështje. Ju jeni për t'i ekzekutuar vendimet e Kuvendit. Ka një vit që është marrë ky vendim e ju nuk jeni në gjendje që ta rregulloni një procedurë. Qytetarët nuk i keni informuar në ëeb-faqen e komunës dhe në asnjë vend publik. Kjo i bjen që nuk jeni të intersuar për qytetarin. Me këtë ja keni vënë pikën për çdo gjë.

Ju jeni institucion, procedurat duhet të jenë të shkruara dhe të vulosura dhe çdo gjë duhet të jetë e qartë. Kur keni me nxjerrë një procedurë si si duhet aplikojnë e ta fitojnë këtë ndihmë nënat? Kur dhe si do ta bëni informimin?

Raimonda Krasniqi: Drejtor, si janë njoftuar këto nëna? Çfarë procedure kanë ndjekur për të përfituar shumën prej 100€? Në cilën listë është kryer pagesa? Ne kemi një listë me 20 emra që kanë përfituar dhe kemi një listë tjetër po ashtu nga ju me 22 emra? A janë 20 apo 22 nëna që kanë përfituar?

Sylë Dukolli: Ne u kompletuam me drejtorët e linjave që duhet të diskutojmë këtu tani.

Pajtohem me parafolësit e mi që duhet të jetë një procedurë dhe një formularë për të aplikuar dhe të bëhet një njoftimi në vende publike qoftë edhe te pediatri, apo këtu tek ofiqari ku bëhet regjistrimi i femijut. Gjithashtu mendoj që është mirë që t'u mundësojmë marrëjen e kësaj ndihme të gjithë atyre nënave prej momentit kur ka hy në fuqi ky vendim në mënyrë retroaktive. Dhashtë Zoti e kem sa më shumë lindje!

Luan Kryeziu: Pershendetje për të gjithë! Po i qasem kësaj pike në një formë tjetër. Mendoj që shuma është e vogël e më shumë i kontribon bankës se sa nënës. Do të ishte më mirë të ndahet një shumë e caktua deri në një moshë të caktuar të fëmijës apo deri në moshën 18 vjeçare, mirëpo ne e dimë gjendjen e komunës dhe atë finaciare që e ka K. e Malishevës. Kjo mund të realizohet në pajtushmeri me nivelin qendror. Pagesa duhet të jetë e rregulltë dhe të zbatohet vendimi por shuma kishte me qenë mirë të ishte pak më e madhe.

Alban Mazreku: Ne e kemi marrë këtu një vendim për mbështetjen e nënave lehona dhe jo të merrmi edhe me puntë e ekzekutivit e t'i vendosim procedurat e njoftimet. Nuk është mirë që t'i njoftoni veç simpatizantët e partisë së juaj por vendimi është për të gjithë qytetarët e Malishevës. Drejtor, a është rastësi apo çka këta emra në listë 90% janë ata që e votojnë NISMA?

Hidajete Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Kryesues kërkoj që debati të jetë konstrutive e të debatojmë veç për temën e caktuar e jo për parti politike. Nuk kam kohë të humb e të dëgjoj fjalë të atyre që flasin çka do. Është mirë të kemi përgjegjësi edhe kur flasim sepse qytetari na ka besuar votën.

Ne punën tonë e kemi kryer e kemi nxjerr vendimin për ndarjen e kësaj shumë, tash përgjegjësia bie mbi ekzekutivin. E vërtetë është që qytetarët nuk janë të informuar edhe pse është marrë ky vendim që 8-9 muaj. Ka forma të ndryshme për t'u informuar.

Ilaz Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Kma një pyetje. Fëmijët që kanë lindur pasi është marr vendimi a kanë të drejtë ato nëna të aplikojnë për këtë ndihmë?

Rrahim Morina: Bëri mirë profesoresha për bëri thirrje për debat konstruktiv dhe të fokusuar për rendin e ditës. Këtë po u kërkoj edhe unë. Vendimi është marrë me 03.07.2018 dhe këtë të drejtë mund ta shfrytëzojnë të gjithë ato nëna që kanë lindur fëmijët nga kjo datë e këtejmi.

Valon Mazreku: Luan për tu shndërrar pagesat si formë e rregullt deri në një kohë të caktuar është çështje që i takon nivelit qendror dhe nuk është në kompetencat tona dhe mundësitë buxhetore tona janë shumë të vogëla.

Nuk është problem ne e bëjmë një formular të aplikimit dhe i përcaktojmë se cilat dokumente duhen për aplikim e t'i dorëzojnë tek Zyra e Pritjes.

E di që kur është marrë vendimi në vitin 2018 ka qenë e planifikuar për vitin 2019, pra të buxhetohet për vitin 2019. Ne sa kemi mundur i kemi përdorur ato format tona për t'i informuar qytetarët të komunimit të drejtëpërdrejtë.

Nëse sot merret një vendim, a duhet detyrimisht fondet të kalojnë llogarinë e nënës apo bënë edhe të atit? Ka pasur shumë përfitues potencial por kur ju kam thënë që duhet llogaria e nënës ata kanë hequr dorë nga kjo. Sepse sipas vendimi këtu ceket nëna lehona. Nëse sot merrni donjë vendim specifikojeni që mundet edhe babait ti dalin këto para në mungesë të llogarisë së nënës.

Rrahim Morina: Po ua lexoj vendimin. “të ndahen nga 100€ për nënat me fëmijë të posalindur, mjetet për këtë vit (fjala është për 2018) të ndahen nga rishikimi buxhetor, kurse për vitin e ardhshëm të planifikohen dhe të përfshihen në buxhetin e Kuvendit Komunal”

A e plotësojmë pak këtë vendim që mënyrë retroaktive të marrin këtë ndihmë të gjitha nënat prej momentit kur ka hy në fuqi ky vendim? Kush është për?

Për: unanimit

Me vota unanime bëhet ndryshim plotësimi i këtij vendimi.

Kalojmë në pikën e 9-të të rendit të ditës: Ndarja e mjeteve financiare me rastin e ndarjes së çmimeve sipas Statutit të Komunës për Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve të Komunës së Malishevës me 16 Qershor 2019, si dhe për vitet në vijim. Nuk jam që të hapet debat për këtë pikë. Deri në këtë vit ju kanë dhënë në zarf çmimet përfituesëve e në këtë vit kanë vendosur që të shkojnë përmes llogarisë rrjedhëse. Për t'ju lejuar Drejtorisë së Financave për t'ju çitur parat përfituesvë duhet vendimi i Kuvendit Komunal e që vlenë ky vendim edhe për vitet në vijim. Kush është për?

Për: unanimit

Kalojmë në pikën e 10-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2019.

Po ju jap një informacion. Në KPF e kemi shqyrtuar këtë çështjen e propozim buxhetit dhe kemi marrur një qëndrim që të thirret një mbledhje urgjente pas kësaj që propozimi i buxhetit të shkoj në dëgjime publike nga Kuvendi. Çështja është veç me ja dhënë vizën për me dal në dëgjim publik.

Valon Mazreku: D. e Financave e ka për detyrë në bazë të ligjit për Menaxhimin e Financave Publike të përgatisë Raportin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhat ashtu siç janë të planifikuara. Ne e kemi përgatitur Raportin për periudhën Janar-Qershor për vitin 2019.

Sipas të dhënave të prezantuara në tabelat përkatëse ashtu siç i keni ju në raport reflekton se K. e Malishevës ka një buxhet të miratuar nga Kuvendi Komunal për vitin 2019 në shumë prej 14,392,379.80€ për të gjitha programet dhe nënprogramet. Kur kësaj shumë i shtohen disa shuma të vogëla të donacioneve të mbetura nga vitet e kaluara në shumë prej 1,440.35€ del që shuma totale e buxhetit është 14,393,520,24€.

Buxheti i alokuar për këtë periudhë arrinë vlerën 9,136,646.64€ që d.m.th që shkalla e realizimit të alokimit të buxhetit është 64%.

Sipas shënimeve të librave të thesarit reflekton që shalla e shpenzimit të buxhetit të alokuar për periudhën Janar-Qershor është 68%, kurse përqindja e tërësishme e buxhetit e shpenzuar për këtë periudhë është 44%.

Në faqet në vijim janë dhënë tabelat e planit të buxhetit, realizimi, shpenzimi i tij sipas programve, burimeve të fondeve, kategorive ekonomike dhe drejtorive në mënyrë sintetike dhe analitike.

Sipas buxhetit të vitit fiskal 2019 nga të hyrat vetanake janë planifikuar 921,023€. Plani i realizimit i të hyrave vetanake për periudhën Janar-Qershor, të hyra të rregullta janë 495,065.98€. Këto të hyra janë futur në sistem dhe janë alokuar, kurse të hyrat të cilat arketohen nga gjobat nga gjykata për këtë periudhë janë 13,790€, kurse gjobat nga trafiku janë 76,863.50€ të cilat gjithashtu janë të alokuara. Pra, të hyrat e gjithëmbarshme vetanake të realizuara për këtë periudhë janë 491,619.48€. Sipas shënimeve aktuale në këtë periudhë Janar-Qershor përqindja e realizimit të të hyrave vetanake është 53.38%.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Hashim Vrenezi: Sa i përketë këtij raporti pothuajse është i njëjti me herat tjera dhe kam pothuajse të njëjtat vërejtje si për raportet e mëhershme.

Kërkoj sqarim tek investimet kapitale, faqe 2, keni raportuar që janë alokuar 91.23% të investimeve kapitale. Nëse dalim tek shpalosa e investimeve kapitale është një përqindje tjetër që thuhet që buxheti është shpenzuar 30.40%. Nuk e kuptoj pse është ky ndryshim?!

Tek Zyra e Kuvendit Komunal, mallëra dhe shërbime, faqe 5 janë të hyra të realizuara që i bie që i kemi në dispozicion 22,833€ apo?

Shqetësuese është tek mallërat dhe shërbime ku shpenzimet janë në rritje dhe nuk ka informacione shtesë për zërat konkret buxhetor se ku janë bërë ato shpenzime. Kërkoj çdo herë një raport të detajuar se për çfarë shpenzohen këto mjete.

Shqetësuese janë vendimet e gjykatave ku komuna ka shpenzuar 80,419€. Ne kemi kërkuar dhe kërkojmë që t'na sillet një listë e këtyre vendimeve gjyqësor. A kemi mund t'u ikim këtyre vendimeve, a ka ndodhur për shkak të neglizhencës së ekzekutivit dhe ta dimë ne pse dëmtohet buxheti i komunës sonë kaq shumë.

Te investimet kapitale ju i keni paraqitur edhe bashkëfinancimet me qytetarët e që është e shpenzuar 100%. Furnizimi i fermerëve me farë dhe plehra është i shpenzuar 100%, investimi në sera dhe pemishte që nuk e dimë se kush janë përfituesit etj.

E kemi pasur edhe një zë buxhetor i cili thuhet që është shpenzuar 100% e që është financimi i ndërmarrjeve prodhuese bujqësore. A keni ndonjë informacion drejtor se cilat janë ato ndërmarrje prodhuese bujqësore që kanë përfituar nga ky zë buxhetor?

Zëri tjetër buxhetor ka qenë i fermerë për paisje me traktorë. Këtu thuhet që është e shpenzuar 100%. Ne nuk e dimë se kujt i keni dhënë traktor ju në K. e Malishevës?!

Dua një informacion tjetër për asfaltimin e rrugëve nëpër fshatra ndërsa janë cekur veç 3 fshatra e thuhet që buxheti është shpenzuar 99.59% a është fjala për projektet që kanë qenë në vazhdim apo çka?

Kam një kërkesë që të gjitha projektet që janë të realizuara do të doja ta kishin edhe pranimin teknik, pra t'na sillni ndonjëherë një raport të projekteve kapitale të realizuar me pranim teknik.

Alban Krasniqi: Do të donja t'na vinte një raport më i kompletuar sepse nga alokimi deri të shpenzimi është një proces i gjatë sepse është prokurimi në mes. Në 6-mujorin e parë që është shpenzuar është 30%, ndërsa 90% janë të alokuara. Pra, ka pasur një guti për shpalljen e projekteve ndërsa realizimi i tyre i disave ka filluar e disave ende nuk ka ndodhur.

Me i kemi dy çerdhe që i kemi planifikuar një në Malishevë dhe një në Kjevojë. Financimi në Kjevojë ka qenë 100%, ndërsa në Malishevë për 2 vjet i ndarë, por as njëra e as tjetra nuk ka filluar. Ne duhet ta dimë deri ku ka shkuar procesi i tyre?

U përmend me plot të drejtë shqetësimi për mjetet e bujqësisë. Ka një shpërprurje të madhe në mes të asaj që Kuvendi e ka miratuar dhe në mes të asaj se si këto mjete janë duke u shpenzuar. Kërkoj nga drejtori që buxheti ashtu siç është miratuar këtu në Kuvend ashtu edhe të shpenzohet. Sa i përket sektorit të shëndetësisë aneksi i Emergjencës as që ka diçka aty e këtu shkruan se mjetet kanë filluar të shpenzohen. Kërkoj sqarim për këtë.

Mirëmbajtja dhe rregullimi i lapidarëve që shuma është 40,000€, por me sa di unë kjo nuk ka ndodhur askund.

Është viti i 3-të radhazi që ndajmë mjete për muzeun, por nuk e di pse nuk po rregullohet muzeu?! Ky më së paku i gjason një muzeu e më së paku është bërë për atë funksion, por ai megjithatë duhet të rregullohet ashtu siç i ka hije.

Këtu është edhe rregullimi i dy parqeve në Marali dhe në Terpezë por ato parqe ende nuk kanë filluar të punohen. Këto është dashur të fillohen të punohen sepse jemi vonë.

Hidajete Mazreku: Valon, sa i përketë këtij raporti po përsëriten të njëjtat gjëra, po edhe vëretjet dhe sygjerimet tona janë po ato. Raporti duhet të jetë pak më i saktë.

Në faqe 16, tek tabelat analitike, tek mallëra dhe shërbime, udhtimet mbrenda vendi. Në total për 6-mujar janë shpenzuar 11, 357€ krahasuar me vitin 2018 këto shpenzime janë rritur. Ku janë shpezuat këto pare dhe pse?

- Te shpenzimet jashtë vendi për këtë periudhë janë shpenzuar 9,787€ e që janë më shumë se viti i kaluar.
- Te shërbimet e ndryshme intelektuale, janë ndarë 17,000€. Kush ka përfituar këtu?
- Paisje speciale të mjeksisë 5,000€. Cilat paisje janë blerë?
- Paisje tjera. Cilat janë ato paisje tjera?
- Furnizime dhe pije zyrtare janë shpenzuar 77,000€. Për çfarë janë bërë këto shpenzime?
- I kemi 44,000€ të planifikuara dhe të shpenzuar për vendimet gjyqësore. Për cilat vendime gjyqësore bëhet fjalë? Etj.

Shpenzimet për investimet kapitale. Edhe këtu i ke vendimet gjyqësore ku janë shpenzuar 80,419€. Për cilat vendime gjyqësore bëhet fjalë Valon?

Me buxhet për mamogrfainë të planifikuara janë 22,000€. Do isha e gëzuar nëse keni filluar të punoni diçka në këtë drejtim. Këtu i keni shpenzuar 6,161€. Përse janë shpenzuar këo para?

Për rregullimin e oborreve të shkollës të palnifikuara janë 40,000€, ndërsa janë shpenzuar 4,662€. Cilët oborre të shkollave janë rregulluar sepse nuk është e specifikuar?

Drejtor, kërkoj që herave tjera në raport të jenë të specifikuar se ku kryhen të gjitha ato shpenzime.

Sadije Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Do të mundhem që të jem sa më e shkurtër në fjalim sepse me të vërtetë janë bërë të bezdishme këto mbledhje të stërzgjatura me nga dy ditë!

Realizimi i të hyrave vetanake për 6-mujorin e parë është pozitive dhe ju përgëzoj sepse janë realizuar 53.38% të palnifikimit të hyrave vetanake. Pra, kemi një rritje rreth 28% krahasuar me vitin e kaluar. Te të hyrat nga tatimi në pronë janë realizuar në këtë periudhë 47.12% dhe krahasuar me vitin e kaluar për të njëjtën periudhë ka një rritje për 17.24%.

Kam disa shqetësime për kategorinë mallëra dhe shërbime ku ka rritje në disa zëra buxhetor e që jam kundër kësaj rritjeve. Kam kërkuar që këto shpenzime të drejtohen kah shpenzimet kapitale.

Drejtor, kategoria e pagave dhe meditjeve a e dëmton kategorinë e investimeve kapitale?

Në buxhetin e vitit 2018 është edhe rruga “Mitrush Kuteli”. Çka është puna me atë rrugë deri ku janë zhvillimet?

Sylë Dukolli: Duke u nisur nga shumat e mëdha marrë sipas planifikimit ky buxhet është i shpenzuar mirë dhe del afërsisht 60% i shpenzuar gjë që është e paraparë me ligj dhe e zbatuar në praktikë.

U diskutua këtu te shpenzimet kapitale rreth alukimit 90% dhe 30% të shpenzuar. Është mirë mjetet alukohen heret në mënyrë që prokurimi të vazhdojë me procedurat e veta sepse ato shpesh vonohen e ka nga ato që kthehen mbrapshtë. Ky alokim është një garancë për këtë.

Sa i përket të hyrave vetanake që janë rritur është për t'u përshendetur puna e qytetarëve tanë dhe që tregojnë ndjenjën shtetërore.

Deri sa ne kemi më shumë investime kapitale se me kategoritë tjera d.m.th që ne jemi mirë si komunë dhe jemi mirë me buxhet dhe nuk po ndalem në detaje.

Alban Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Po nisem nga diskutimi i Sadijes që tha që janë rritur të hyrat nga tatimi në pronë. Të hyrat nga tatimi në pronë janë rritur për shkak që janë shtuar disa kategori tjera përveç shtëpive të banimit.

Shumicën e gjerave e thanë edhe parafolësit e mi, por unë kam Planin e Prokurimit dhe aty kanë qenë të planifikuar edhe koha kur duhet të hapen procedurat e prokurimit për investimet kapitale dhe të tjera.

Analizuar planifikimin e buxhetit për këtë vit, raportin e juaj dhe planifikimin e prokurimit këto nuk përputhen asnjëra me tjetrën.

Te hartimi i projekteve vlera është 60,000€ siç është ndërtimi i qendrës për kategoritë e dalura nga lufta është planifikuar me 21.03.2019 sipas prokurimit, por kjo nuk ka ndodhur.

Ndërtimi i rrugës prej urës kryesore deri te ura e minitransitit nga të dyja anët rreth lumit "Mirusha" e planifikuar me 08.04.2019 të hapet tenderi, e kjo sipas drejtorit të Urbanizmit thuhet se as projekti nuk është gati.

Renovimi i objektit të komunës së vjetër, ne jemi këtu dhe jemi duke e parë që asnjë punim nuk është duke u për këtë. Kjo e planifikuar në muajin e 4-ërt. Të tjera janë rregullimi i parkut në Malishevë e Gurbardh, instalimi i nxemjeve qendrore në komunën e re në buxhet nuk është e planifikuar e këtu në raport është si shpenzim, ndërtimi i rrugëve, renovimi i qendres sportive, ndërtimi i çerdhës në Kjevë, ndërtimi shkollës në Gurbardh e raste të tjera.

Ali Morina: Drejtor, te shpenzimet e mallërave dhe shërbimeve diku ka ulje të shpenzimeve por më shuam ka ngritje e që është mbi 121,000€ krahasuar me periudhën e viti të kaluar në këtë vit. Te shërbimet e avokatisë për këtë periudhë kemi shpenzime 0, ndërsa nëse e bëjmë krahasimin me vendimet gjyqësore janë diku 125,000€ që ka paguar komuna. Pse ka ndoshur kjo?

Rrahim Morina: Shkojmë në pushimin e drekës, kthehemi pas 1 ore.

Pas pushimit të drekës mund të vazhdojmë mbledhjen sepse kourrum ka, dhe jemi te diskutimi i pikës Kalojmë në pikën e 10-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2019.

Drejtor, pse nuk ka të hyra nga asrisimi? E di që bëhen pagesa në këtë kategori por ju nuk i keni paraqitur ketu madje as si zë buxhetor. Drekat dhe darkat zyrtare krahasuar me vitin e kaluar janë trefishuar për këtë periudhë.

Ne vazhdimish kemi kërkuar specifikacion në raport për projektet që janë realizuar, që janë në realizim e sipër si dhe për ato që do të realizohen.

Valon Mazreku: Kryesues, Drejtoria e Financave nuk i monitoron projektet dhe ne nuk e dimë se në cilën fazë janë. Ne e dimë veç kur e bëjmë zotimin dhe e inicojmë si procedurë për prokurim.

Hashim, tek shërbimet tjera kontraktuese hynë disa pagesa për të cilat nuk ka kod adekuat ekonomik si psh: higjena, marrëveshjet që i kemi me Ministrinë e Punës nga i pagujmë detyrimet tona, kontratat mbi vepër etj.

Është fakte që sa i përket bashkëfinancimit që janë harxhuar ato mjete në kuadër të së cilës ne i kemi paguar një shumë të konsiderueshme për Qendren e Banimit Social në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Sa i përket pyetjeve që bërë për bujqësinë më duhet të hy në sistem të Menaxhimit për Financat Publike për t'i parë saktësisht se si është situata aty.

Alban, alokimi i mjeteve bëhet me plan kontabël në fillim të vitit dhe shpenzimi është atëherë kur kryhet puna dhe bëhet pranimi i punëve të kryera, prandaj ashtu e keni të paraqitur në raport.

Sa i përket Emergjencës me sa di unë ka filluar procedura e ndërtimit të tij pasi që ka pasur një koplikim të situatës sepse Bena-F ka qenë i detyruar që ta ndërtoj atë objekt. Ndërsa është në tenderim projekti për nxemjen qendrore të Muzeut të Qytetit.

Hidajete, te shpenzimet e udhëtimit mbrenda vendit hynë edhe transporti i nxënësve nëpër disa fshatra të Malishevës. Te shpenzimet intelektuale dhe këshillëdhënëse kryesisht janë të paguara komisionet dhe komitetet që i keni formuar ju si Asamble.

Te furnizimi me ushqim dhe pije, kryesisht hynë shpenzimet për çerdhen.

Alban Manzreku, në rritjen e të hyrave nga Tatimi në Pronë ka ndikuar përveç ligjit që pagesa të bëhet për tërë pronën e palujshme edhe angazhimi ynë me një plan të palodhshme në atë sektor.

Profesoreshë, për të gjitha pyetjet që nuk ke marrur përgjigje bëjeni një kërkesë me shkrim drejtohuni drejtorisë sonë dhe do të mundohem që brenda afatetve ligjore t'ju përgjigjem.

Rrahim Morina: Kalojmë në pikën e 11-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit të DKAE-së për përfundimin e vitit shkollor 2018/2019 si dhe shqyrtimi i raportit për përgatitjet e fillimit të vitit shkollor 2019/2020. Drejtori me leje mungon por e ka dërguar përfaqësesin e tij Halim Hotin.

Është kërkesë e grupeve politike të opozitës që kjo pikë të shtyhet në mungesë të drejtorit sepse ata duan të diskutojnë kur drejtori është këtu. Po e hedhi në votim. Kush është që kjo pikë të shtyhet për një mbledhje tjetër?

Për: unanimisht

Kalojmë në pikën e 12-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Bujqësi për përfundimin e korrje-shirjeve. Drejtori nuk është këtu dhe keni kërkuar që edhe kjo pikë të shtyhet. Ne ju kemi drejtuar drejtorit me një kërkesë që t'na sjellë një shkresë me ermat e përfituesvë të të gjitha subvencioneve për vitin 2019. Ne nuk e kemi marrur përgjigje për këtë.

Nebih Bibaj: Kryesues, kërkoj që kur të vie përsëri kjo pikë të vije edhe raporti për korrje-shirjet për këtë vit.

Rrahim Morina: A jeni që edhe kjo pikë të shtyhet për një mbledhje tjetër?

Për: uananimisht

Kalojmë në pikën e 13-të të rendit të ditës: Inicimi i procedurave për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Transparencën në Komunën e Malishevës. Ne e kemi një rregullore por kjo duhet të harmonizohet me udhëzimin administrative. Mendoj që është mirë veç ta votojmë për debat publik pastaj të vie këtu. Është mirë që ta formojmë një komision për këtë rregullore. Atëherë kush është pro inicimit të procedurave për debat publik dhe formimin e komisionit për Rregulloren për Transparencë?

Për: unanimit

Me votim unanimit u inicuan procedurat për debat publik dhe formimi i Komisionit për Rregulloren për Transparencë.

Kalojmë në pikën e 14-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës nr.02/477 datë:23.08.2019 e parashtruar nga Kryesuesi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për mbështetje financiare për funksionalizimin e Bordit të Drejtorëve të NPK “ Stacioni i Autobusëve” SH.A në Malishevë. Alban Krasniqi e ka fjalën si kryesues i këtij komisioni.

Alban Krasniqi: Ne si komision kërkojmë një shumë minimale 5,000€ për të funksionalizuar bordin e kësaj ndërmarrje, pavarësisht asaj që Kryetari nuk e ka dërguar përfaqësuesin e vet. Me këtë shumë do të paguhej bordi dhe do të rregullohej ambienti mbrenda në stacion me gjitha paisjet e punës dhe të zyrës. Kjo shumë mund të sigurohet nga të hyrat vetanake.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Sylë Dukolli: Me të vërtete Stacioni i Autobusëve në Malishevë le për të dëshiruar duke filluar nga papastëritia e deri të interieri i mbrendshëm që është i shkallmuar dhe me një pamje jo të mirë. E vërteta është se gjithëmonë na ka munguar një raport i mirëfilltë dhe specifik.

Mendoj që duhet të ndihmohet kjo ndërmarrje, por për shkak që jam shkarkuar nga kjo Asamble si anëtar i këtij Komisioni do të abstenoj.

Ali Morina: Sa i përket kësaj kërkesë mendoj që shifrat janë reale sepse 3,200€ për pagesën e anëtarëve të bordit, ndërsa shifra tjetër 1,800€ është për funksionalizimin e një zyre ku ata të kenë një vend ku të punojnë.

Pse nuk është funksionalizuar ky bord deri me tani, është ekzekutivi ai që e ka penguar këtë, të vetmen ndërmarrje publike në K.e Malishevës.

Alban Mazreku: Ne grupi ynë e përkrahim këtë kërkesë, por të obligohet bordi apo kush do qoftë që të bëjë raporte të qarta dhe të raportojnë para Asamblesë.

Rrahim Morina: Raportin e përgatit Komisioni Komunal i Aksionarëve dhe raporton para Kuvendit.

Para se ta qesë në votim duhet të saktësohet që mjetet të merren nga të hyrat vetanake. Kush është pro miratimit të kësaj kërkesë?

Për: 16

Kundër: 0

Abstenim:2

Valon Mazreku: Të hyrat vetanake të cilat grumbullohen nga Komuna përmes drejtorive që buxhetohen. Kur kërkohet alokimi i tyre, kërkohet me projekte të cilat janë miratuar me buxhet. Pra, është e njëjtë si me i marr nga ati si nga granti i përgjithshëm i qeverisë sepse ato janë të buxhetuara me buxhet. Pra kërkesa të jetë e specifikuar se nga cili projekt duhet të merren këto para.

Rrahim Morina: Atëherë ne drejtor do të lejojmë që këto para të merren nga shërbimet tjera kontraktuese për ndërmarrjen e Stacionit të Autobusëve. Kush është pro që këto para të merren nga shërbimet tjera kontraktuese?

Për: 16

Kundër: 0

Abstenim: 4

Kalojmë në pikën 15-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i i kërkesës nr.02/468 datë: 16.08.2019 e parashtruar nga Kryesia e fshatit Carrallukë, për ndërtimin e rrethrotullimit në vendin ku kryqëzohet rruga “Hilmi Hoti” me trasenë e transitit. Në këtë rast se a do ti drejtohem Ministrisë sepse është projekt i Ministrisë e të kërkojmë që të bëhet një rrethrotullim. E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Krasniqi: Ky rreth që është duke u ndërtuar është i finacuar nga Ministria, por është nën përgjegjësinë e komunës. Pra, komuna e ka përsipër për të vendosur si për trase ashtu edhe për çdo gjë tjetër si pjesë e kategorisë së rrugës që i përketë kjo. Kjo nuk është rrugë regjionale e as nacionale, pra hynë në kuadër të rrugëve lokale, prandaj vendimmarrjen e marrim ne. Ne duhet të gjejmë një zgjidhje për këtë. Fshatarët e Carrallukës e kanë paraparë saktë se si të trajtohet kjo çështje. Aty përveç makinave do të kalojnë edhe këmbësor këtë duhet ta kemi parasysh.

Rrahim Morina: Është mirë që së bashku ta gjejmë një zgjidhje si të dilet nga kjo. A mundemi ne që ta atuorizojmë Kryetarin që ai në bashkëpunim me Ministrinë të gjejnë një zgjidhje? Ne edhe pse e kemi kërkuar projektin, ne kurrë se kemi parë.

Ilaz Krasniqi: Rruga “Hilmi Hoti” e lidh fshatin Carrallukë, Drenoc, Vërmicë. Kur ka filluar traseja e rrugës ne jemi intersuar për këtë çështje dhe atë ditë e kemi takuar një ingjnier përgjegjës të Ministrisë dhe e kemi parë projektin dhe aty është i paraparë veç një kryqëzim i rrugëve.

Përfaqësuesit e fshatit së bashku me mua kemi kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit se çka është e paraparë me projekt dhe të ndërhyjnë aty për çështjen e sigurisë së qytetarve. Ne i kemi grumbulluar disa nënshkrime dhe i keni këtu së bashku me kërkesë.

Sylë Dukolli: Gjithëkund ku ka kryqëzim dhe kalojnë makineritë e rënda është normale që të ketë një rreth-rrotullim. Projektin nuk e kam parë, por Dibran nëse ka projekt ashtu siç thua ti është mirë që ta shohim edhe ne sepse po filitet për komunën tonë. Është mirë që ta gjejmë një zgjidhje sepse ju kemi borxh atyre banorëve.

Ilaz Krasniqi: Atë ditë që u takuam rastësisht me atë mbikqyrësin e projektit nga Ministria propozoi që kërkesa të bëhet në Kuvend e pastaj nga këtu atje. Ai e shënoi si vërejtje në librin e tij por pa kërkesën nga Kuvendi dhe nga Drejtoria e Urbanizmit nuk mundemi të ndërhyjmë. Kështu tha ai.

Valon Mazreku: Projekti është sepse një tranzit i tillë nuk mund të bëhet pa projekt. Në projekt nuk është e specifikuar a ka urë apo rreth-rrotullim. Siaps projektit ajo rrugë do të prehet dhe do të mbetet si kryqëzim. Kompania kontraktuese së bashku me organin mbikqyrës që është Ministria e Infrastrukturës ju kanë thënë qytetarëve që të bëjnë një kërkesë e të adresohet në Kuvend. Kuvendi merr vendim për të ndryshuar aty të bëjë rreth-rrotullim ose në bazë të nevojave të qytetarëve që e përcaktojnë profesionistët e kësaj fushe dhe e autorizojnë Drejtorinë për Urbanizëm që vendimi që merr Kuvendi të shkojë në Ministri për këtë çështje.

Alban Mazreku: Valon ne e dimë që ka projekt por nuk e keni prurë këtu edhe pse e kemi kërkuar shumë herë.

Drejtor, kur qytetarët po duan të ndërtojnë diçka ndonjë objekt apo diçka tjetër në tokë bujqësore po kërkojnë këtu miratimin për destinimin e tokës në tokë ndërtimore. Toka ku do të shtrohet e ndërtohet tranziti është tokë bujqësore e këtu nuk ka ardhur asnjëherë një kërkesë e tillë.

Sa i përket kërkesës së banorëve të Carrallukës është mirë që të marrim një vendim e ta rekomandojmë Drejtorinë e Urbanizimit që të gjejnë një zgjidhje teknike që a është më mirë me qenë rreth-rrotullim apo diçka tjetër.

Propozoj që të ndërprehen punimet deri sa të gjindet një zgjidhje te ajo pjesë.

Rrahim Morina: A mund ta plotësojë pak propozimin e juaj që Kryetari mbrenda 1 muaji të vie me zgjidhje të kësaj çështje. Me cek në vendim që mbrenda 1 muaji të kemi informacion për këtë çështje nga Kryetari.

A formulojmë kështu: të autorizohet Kryetari së bashku me Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Kadastrës dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës që ta gjejnë një zgjidhje rreth kësaj çështje dhe mbrenda 1 muaji të marrim informacione rreth kësaj çështje. Kush është për?

Për: unanimit

Kalojmë në pikën e 16-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës nr.02/471 datë:20.08.2019 e parashtruar nga Kryesia e fshatit Llazicë, lagja Buzhala, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shtëpisë (odës) së pritjes për komunitetin e lagjes Buzhala dhe për ndërtimin e parkut. Materialin e keni. I kanë kërkuar 5 ari për odën dhe 20 ari për parkun. E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Mazreku: Ne grupi ynë plotësisht e mbështesim këtë kërkesë të banorëve të fshatit Llazicë, por me këtë vendim të obligohet Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastrë që në bazë të kësaj kërkeje t'i vendos pikat.

Rrahim Morina: Mbase s'ka diskutues të tjerë shkojmë në votim. Kush pro kësaj kërkeje të banorëve të fshatit Llazicë dhe të obligohet drejtoria e Gjeodezisë ashtu siç kërkoj Albani?

Për: unanimit

Kalojmë në pikën e 17-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës nr.02/436 datë:12.07.2019 e parashtruar nga zj. Lumturie Berisha nga fshati Drenovc, për mbështetje financiare për shërim. Ne në KPF e kemi diskutuar këtë çështje dhe e kemi përcjellur për Kuvend. Propozoj që t'i ndahet një shumë prej 2.000€. Kush është për që znj. Lumturie Berisha t'i ndahen 2,000€ për shërim nga Kuvendi Komunal në Malishevë?

Për: unanimit

Me votim unanim i ndahet kjo shumë Znj. Lumturie Berisha nga Drenoci.

Kalojmë në pikën e 18-të të rendit të ditës: Shqyrtim i kërkesës nr.06/67 datë: 17.06.2019 e parashtruar nga z. Kaqanik Balaj nga Komuna e Istogut për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në zonën kadastrale në fshatin Mleqan KK. Malishevë. E hapi debatin për këtë pikë.

Meqë s'ka debatues kush është pro miratimit të kësaj kërkeje?

Për: unanimit.

Kalojmë në pikën e 19-të të rendit të ditës: Shqyrtim i kërkesës nr.02/445 datë: 18.07.2019 e parashtruar nga z. Egzon Gashi nga fshati Ngucat për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Materialin e ka të kompletuar kjo kërkesë. Atëherë kush është pro miratimit të kësaj kërkeje?

Për: unanimit

Kalojmë në pikën e 20-të të rendit të ditës: Kërkesa është për vendimi nga mbledhja e kaluar e që është bartja e mjeteve ose ridestinimi i mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2017 për vitin 2018 dhe viti 2018 në vitin 2020. Pa kërkohet veç ndryshimi i kodeve buxhetore ndërsa projektet mbeten ashtu siç i kemi votuar.

Valon Mazreku: Te bartja e të hyrave vetanake kanë thënë që duhet të ruhet grati specifik i shëndetësisë dhe ai i arsimit. Ligji i Buxhetit, neni 6.3 dhe 4 thotë kështu: Të hyrat vetanake komunale nga arsimit regjistrohen veçmas dhe të hyrat e tilla duhet të shfrytëzohen nga komuna vetëm për qëllime të arsimit. Në këtë pikë jemi në rregull sepse një shumë rreth 1,000€ i keni vendos te rregullimi i murit mbrojtës në shkollën e Vërmicës dhe pjesa tjetër për instalimin e nxemjes qendrore në shkollën “Visar Krasniqi” në Drenoc.

Të hyrat vetanake nga bashkëpagesat për kujdesin primar parësor shëndetësor regjistrohen veçmas dhe të hyrat e tilla autorizohen të shfrytëzohen nga komuna vetëm për qëllime shëndetsore.

Ne kur i kemi ndarë 53,138.60€ janë mbetje nga programi i shëndetësisë. Këto duhet t’i ndajmë në programin e shëndetësisë. 73% i kam nda në sektorin e shëndetësisë dhe një pjesë tek sektori i arsimit sepse i përgjigjet këtij sektori. Pra na duhet që t’i bartim këto mjete në këto kode, por projektet nuk lëvizin.

Rrahim Morina: Hashim, ne vendimin e kemi dërgar në MAPL, ata e përcjellin në Ministrinë e Financave. Ministria e Financave në këtë rast ka kthyer një shkresë që mejtet nga të hyrat vetanake nuk ka mundësi të barten nga granti i shëndetësisë e të buxhetohen diku tjetër. Drejtori tha projektet nuk preken veç i qesim në kodin për shëndetësi.

Mirë mbase nuk po pajtohem i lëjmë për mbledhjen tjetër dhe e shqyrtojmë. Me këtë mbledhjen e shpalli të mbyllur e shihemi në mbledhjen tjetër.

Mbledhja përfundoi në ora 15:50.

Procesmbajtësja: Samire Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit: Rrahim Morina
